



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË



# ZGJEDHJET VENDORE 21 QERSHOR 2015



**MANUAL**  
**I KOMISIONIT TË ZONËS SË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR**  
**KZAZ** **Pjesa e dytë**

## Kodi i sjelljes për komisionerët zgjedhorë

Për t'iu përmbajtur parimeve bazë të administrimit të zgjedhjeve, siç parashikohet në ligj, në mënyrë të veçantë kërkesave për legjitimitet, transparencë, paanshmëri dhe profesionalizëm, komisionerët zgjedhorë duhet:

- Të punojnë për t'i ofruar çdo votuesi cilësinë më të lartë të shërbimit të kërkuar për t'u mundësuar votuesve të ushtrijnë të drejtat e tyre dhe të sigurojnë zhvillimin e zgjedhjeve demokratike.
- Të kryejnë detyrën në mënyrë të pavarur, transparente dhe të paanshme.
- Të punojnë konform ligjeve shqiptare, të zbatojnë kodin zgjedhor, vendimet dhe udhëzimet e KOZ-së dhe t'i përmbushin plotësisht detyrimet e tyre, për të siguruar zgjedhje të standardeve ndërkombëtare të lira, të drejta dhe transparente.
- Të marrin vendime të qarta dhe të kuptueshme për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor.
- Të zhvillojnë mbledhje të hapura për të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor, përfshirë edhe aksesin e lirë në informacionin, mbi bazën e të cilit merren vendimet.
- Të kryejnë të gjitha detyrat e tyre në mënyrë profesionale dhe larg ndikimeve politike.
- Të trajtojnë të gjithë pjesëmarrësit në procesin zgjedhor (kandidatët, partitë politike dhe votuesit) në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, pa i dhënë avantazh ndonjë partie politike apo grupi interesi.
- Të trajtojnë përfaqësuesit e mediave me mirësjellje dhe respekt.
- Të veprojnë në mënyrë profesionale.
- Të jenë të trajnuar dhe disiplinuar, si dhe të angazhuar të trajtojnë materialet zgjedhore me kujdes dhe respekt.
- Të respektojnë standardet më të larta të etikës në lidhje me kandidatët, vëzhguesit votuesit dhe komisionerët e tjerë zgjedhorë.
- Të sillen në mënyrë të pagabueshme, të ushtrijnë gjykim të shëndoshë dhe të kenë standardet më të larta të maturisë personale.
- Të mospranojnë ndonjë dhuratë apofavorngapartitë politike, organizatat apo personat, të cilët mundosejotë jenë të përfshirë në procesin zgjedhor.
- Të mos mbajnë apo tregojnë simbole apo ngjyra partiake të dukshme.
- Të mos shprehin pikëpamje mbi tema, të cilat mund të jenë çështje politike në zgjedhje.
- Të mos marrin pjesë në aktivitete të paautorizuara, përfshi edhe aktivitetet private, që mund të çojnë drejt një konflikti aktual apo të perceptuar interesime detyrat e tyre si administrues zgjedhorë.
- Të deklarojnë çdo marrëdhënie që mund të çojë në konflikt interesi me detyrat e tyre.

## **PËRMBAJTJA**

<b>KREU I -PËRGATITJA DHE ORGANIZIMI I VENDEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE.....</b>	<b>5</b>
1.Përgatitja e Vendit të Numërimit tëVotave.....	5
2. Personat e pranishëm, rregulli dhe qetësia në Vendin e Numërimit të Votave.....	6
3.Vëzhguesit.....	7
<b>KREU II - GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE.....</b>	<b>9</b>
1. Caktimi i Grupeve dhe Tavolinave të Numërimit të Votave.....	9
2.Paraqitja e propozimeve nga partitë politike për emërimin anëtarëve të GN-it.....	9
3.Procedura e zgjedhjes për numëruesin e parë dhe sekretarin e GNV-ve.....	10
4.Zëvendësimi i anëtarëve të Grupit të Numërimit.....	10
5.Procedura e shortit për zëvendësimin e anëtarëve të GNV-ve.....	10
6.Kur vendi i një anëtar të GNV mbetet vakant gjatë procesit të numërimit të votave.....	11
<b>KREU III -DËRGIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE NGA KOZ PËR KZAZ, KOV dhe GNV.....</b>	<b>11</b>
<b>1. Dorëzimi i materialeve zgjedhore në KZAZ .....</b>	<b>11</b>
2.Dorëzimi i materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja në çdo KOV .....	15
2.1 Materiale zgjedhore jashtë kutisë, të cilat i dorëzohen KOV-së nga KZAZ-ja.....	15
2.2 Procedura për dorëzimin e vulës së kryetarit të KOV-së.....	15
3.Materialet zgjedhore për GN-të .....	16
<b>KREU IV - VEPRI MET E KZAZ-SË GJATË DITËS SË VOTIMIT.....</b>	<b>17</b>
1. Veprime të KZAZ-së gjatë ditës së zgjedhjeve .....	17
2. Transmetimi i informacionit ditën e votimit .....	17
<b>KREU V – MARRJA NË DORËZIM E MATERIALEVE TË SJELLA NGA KOV NË VNV.....</b>	<b>18</b>
1. Dërgimi i materialeve zgjedhore nga KOV në VNV.....	18
2. Ngritja e grupeve për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore.....	19
3. Detyrat e grupit të marrjes në dorëzim.....	19
4. Marrja në dorëzim të materialeve zgjedhore të sjella nga KOV-ja në VNV.....	19
5. Konstatimi dhe deklarimi i Kutive të Parregullta.....	20
6. Sistemimi i kutive të votimit dhe materialeve të votimit në VNV.....	22
<b>KREU VI -VEPRIMET E KZAZ PAS MARRJES NË DORËZIM TË MATERIALEVE ZGJEDHORE...23</b>	<b>23</b>
1. Veprimet paraprake të KZAZ-së.....	23
2.Fillimi i procesit të numërimit të votave.....	23
3.Radha e numërimit .....	23
4.Detyra të KZAZ-së gjatë procesit të numërimit të votave nga GN-të.....	23
<b>KREU VII - TRANSMETIMI ELEKTRONIK DHE NXJERRJA E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE.....</b>	<b>24</b>
1.Veprimet para plotësimit të Tabelës së Rezultateve të Votimit.....	25
2.Transmetimi elektronik i të dhënave të pasqyruara në Tabelën e Rezultateve të QV-së, model 56-15 dhe model 57-15.....	25
3. Nxjerrja e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zgjedhjeve nga KZAZ-ja.....	26
3.1.Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KZAZ-ja për Kryetarin e Bashkisë.....	26
3.2.Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KZAZ-ja për këshillin bashkiak.....	27
4. Ankesa.....	28
<b>KREU VIII - PAS ZGJEDHJEVE - DËRGIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE NË KOZ.....</b>	<b>28</b>
<b>KREU IX - PËGJEGJËSITË DHE SANKSIONET E ANËTARËVE TË KZAZ-SË dhe GNV-së.....</b>	<b>30</b>
<b>KREU X- SHEMBUJ PRAKTIKË TË VEPRI MEVE TË KZAZ-SË.....</b>	<b>30</b>

Letër përshëndetëse

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor

Manuali i KZAZ-së është konceptuar për t'u ardhur në ndihmë anëtarëve të KZAZ-ve në veprimtarinë e tyre për administrimin e procesit në zonën e administrimit zgjedhor nga përgatitja e Vendit të Numërimit të Votave deri në dorëzimin e materialeve zgjedhore në KQZ.

Manuali përmban detyrat e KZAZ-së në VNV, vendimet dhe dokumentacionin e KZAZ-së, përgjegjësitë dhe sanksionet për anëtarët dhe sekretarin e KZAZ-së.

Komisionerët gjatë trajnimit do të përdorin modelet e vendimeve dhe dokumentacionit të punës, me qëllim që të përvetësojnë sa më mirë të gjitha procedurat e parashikuara në Manualin e KZAZ-së pjesa e dytë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve kërkon që gjatë punës tuaj, të gjithë aktorët në proces:

- ✓ t'i trajtoni në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, pa i dhënë avantazh ndonjë partie politike apo grupi interesi;
- ✓ të respektoni standardet më të larta të etikës jo vetëm me disa nga aktorët e rëndësishëm, por edhe me komisionerët e tjerë zgjedhorë;
- ✓ të zbatoni me përpikmëri Kodin Zgjedhor, vendimet dhe udhëzimet e KQZ-së për mbarëvajtjen e një procesi zgjedhor me integritet, paanshmëri dhe transparencë, duke mbrojtur pavarësinë e funksioneve tuaja.

KQZ vlerëson angazhimin tuaj dhe beson se do t'i përmbushni plotësisht detyrimet tuaja, për të siguruar dhe garantuar zgjedhje të standardeve më të larta, demokratike, të lira, të drejta, transparente dhe të pranuar nga të gjithë aktorët në këtë proces.

Duke ju uruar suksese në punën tuaj, si pjesë e kontributit qytetar për zhvillimin e zgjedhjeve, ju falenderojmë përpërfshirjen tuaj në procesin zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 qeshor 2015.

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Shkurtime që përdoren në manual

KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
DKZTEZ	Drejtoria e Komisioneve Zgjedhore, Trajnimit dhe Edukimit të Zgjedhësve
RSH	Republika e Shqipërisë
ZAZ	Zona e Administrimit Zgjedhor
ZRZ	Zyra Rajonale Zgjedhore
KZAZ	Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor
KOV	Komisioni i Qendrës së Votimit
GNV	Grupet e Numërimit të Votave
LPM	Libri Protokollit të Mbledhjeve
VNV	Vendi i Numërimit të Votave
Teknologjia mbështetëse	Teknologjia mbështetëse e numërimit të votave

## KREU I - PËRGATITJA DHE ORGANIZIMI I VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE

Vendndodhja e VNV-së caktohet me vendim të KQZ-së, jo më vonë se 40 ditë ditë nga data e zgjedhjeve, sipas kriterëve të përcaktuara në nenin 93 dhe 94 të KZ, përcaktimeve të Udhëzimit të KQZ-së nr.4/2015.

KQZ-ja, në bashkëpunim me organet e tjera qendrore ose vendore, siguron pajisjet e nevojshme logjistike përfshirë edhe ndriçimin e pandërprerë, për fillimin dhe mbarëvajtjen e procesit të numërimit të votave në VNV.

Vendet e Numërimit të Votave vihen në dispozicion të KZAZ-ve jo më vonë se dhjetë ditë para datës së zgjedhjeve.

### 1.Përgatitja e VNV

Menjëherë me marrjen në dorëzim nga KQZ-ja të VNV-së, KZAZ-ja në bashkëpunim me organet e qeverisjes vendore, merr masa për:

- krijimin e kushteve të përshtatshme për instalimin e teknologjisë mbështetëse;
- rregullimin përfundimtar të VNV-së, sipas planvendosjes (skema1) të miratuar me Udhëzimin e KQZ-së nr.4/2015;
- ruajtjen nga dëmtimet e jashtme të kësaj teknologjie nga momenti i fillimit të procesit të numërimit të votave në VNV deri në nxjerrjen e rezultatit të ZAZ-së;
- vendosjen e strukturës ndarëse të hapësirës së vëzhguesve, kandidatëve dhe mediave me hapësirën për numërimin e votave;
- vendosjen e shenjave/tabelave treguese të dërguara nga KQZ;
- vendosjen e tabelave treguese për drejtimin e lëvizjes në mjediset e brendshme të VNV-së;
- vendosjen e pajisjeve logjistike të nevojshme për kryerjen e procesit të numërimit.

Kujdes!

KZAZ-ja organizon hapësirën e VNV-së në mënyrë të tillë që:

Hapësirat ku kryhet numërimi i votave të jenë të mjaftueshme dhe të ndara qartë nga hapësirat për vëzhguesit, kandidatët dhe mediat.

Ndërtesat e VNV duhet të kenë:

- ndriçim dhe energji elektrike të mjaftueshme për të suportuar për teknologjinë mbështetëse të numërimit të votave;
- më shumë se një derë, për komunikimin me mjedisin e jashtëm;
- ndarjen e hapësirës së publikut nga zona e numërimit të votave;
- pajisje me mjete mbrojtje kundra zjarrit si dhe të ndihmës së shpejtë.

Pajisjet e nevojshme:

	Tavolina	Karrige	Kompjuter	Printer	Fotokopje	skaner	Tel/Fax
KZAZ	2	8	1	1	1	1	1
Ndihmësi teknik	1	2					
Për çdo GN	1	4					

Tabela 1

Një pjesë e pajisjeve logjistike, ofrohen edhe nga administrata/institucioni ku është

vendosur objekti i VNV-së (Tabela 1).

KZAZ-ja i vendos tavolinat e punës për çdo grup numërimi, duke siguruar që ato:

- të kenë hapësirë të mjaftueshme për kryerjen e procesit të numërimit të votave;
- të jenë të shikueshme nga anëtarët e KZAZ-së, vëzhguesit, kandidatët, përfaqësuesit e akredituar të medias;
- të mundësojnë aplikimin e teknologjisë mbështetëse, ku të shfaqen qartë fletët e votimit në monitorët e instaluar;
- të parandalojnë dhe të pengojë kontaktin fizik të personave të tjerë/ paautorizuar të pranishëm në VNV me materialet e votimit.

Kujdes: VNV-ja duhet të ketë infrastrukturën logjistike për fillimin dhe mbarëvajtjen e procesit të numërimit të votave dhe KZAZ-ja, jo më vonë se 5 ditë para datës së zgjedhjeve, fton për njohje të VNV-së subjektet zgjedhore dhe anëtarët e KQV-ve. n.94, p.1 e KZ, udhëzimi i KQZ-së nr.5/2015

-Regjistrimi filmik i procesit ruhet në mënyrë elektronike dhe dorëzohet në KQZ së bashku me materialet e tjera zgjedhore Ju mund t'i referoheni n.94, p.4 e KZ.

## 2. Personat e pranishëm, rregullli dhe qetësia në Vendin e Numërimit të Votave

Me fillimin e procedurës së numërimit të fletëve të votimit, në VNV duhet të qëndrojnë vetëm:

- a) Anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së;
- b) Anëtarët e Grupeve të Numërimit të Votave të caktuar me vendim të KZAZ-së, të cilët futen në punë;
- c) Përfaqësuesit e akredituar të medias;
- ç) Vëzhguesit e subjekteve zgjedhore;
- d) Vëzhguesit e tjerë të akredituar;
- dh) Kandidatët për kryetar Bashkie dhe kandidatët e mbështetur nga zgjedhësit;
- e) Operatorët e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave;
- ë) Stafi i KQZ-së i pajisur me autorizim nga KQZ, si:
  - ✓ Trajnuesit e Grupeve të Numërimit,
  - ✓ Inspektori i Zyrës Rajonale Zgjedhore.

Të gjithë personat e pranishëm në VNV, duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi për të verifikuar identitetin e tyre.

- ❖ KZAZ-ja kontrollon në hyrje të VNV-së saj, nëpërmjet një anëtari të saj, personat që lejohen të jenë të pranishëm në VNV. Anëtari i KZAZ-së pajiset me një listë të miratuar nga KZAZ me emrat e personave që lejohen të jenë të pranishëm në VNV.

Anëtari i KZAZ-së lejon të hyjë në VNV çdo person, që:

- është i pajisur me autorizim/akreditim të lëshuar nga KQZ-ja ose KZAZ-ja dhe dokument identifikimi të vlefshëm (letër njfoftimi apo pasaportë).



- i përputhen të dhënat e dokumentit të identifikimit/autorizimit/akreditimit të lëshuar nga KQZ-ja ose KZAZ-ja me emrin, mbiemrin që gjendet në listë.

Kujdes: Ju mund t'i referoheni KZ n.121/ p.1. KZAZ merr masa dhe është përgjegjëse për moslejimin e personave të paautorizuar apo të pa akredituar nga KQZ ose KZAZ.

Në çdo rast, të shkëljes n.121 të KZ, KZAZ me vendim, menjëherë, njofton punonjës të Policisë së Shtetit dhe rasti mbahet shënim në LPM të KZAZ-së, duke përfshirë/shënuar edhe orën e saktë të ardhjes dhe largimit të punonjës të Policisë së Shtetit (KZ, neni 121/2)

Punonjësi i Policisë së Shtetit thirret në VNV vetëm për të rivendosur rendin.

Hyrja dhe largimi i tij nga VNV, bëhet pasi të jetë marrë vendim nga KZAZ:

Për kërkimin e ndihmës nga Policia e Shtetit në VNV, MODEL–17V KZAZ

Për largimin e Policisë së Shtetit nga VNV, MODEL–18V KZAZ , \*Ky vendim merret nga KZAZ-ja pasi është vendosur rendi në VNV.

Udhëzimi KQZ-së nr.7, datë 23.03.2009, i ndryshuar, Vendimi KQZ-së nr.164, datë 21.04.2015

### 3. Vëzhguesit

Vëzhguesit qendrojnë përballë dhe në largësi të vogël nga hapësira ku do të vendosen tavolinat e numërimit ose nga monitorët kur përdoret teknologjia mbështetëse për numërimin e votave.

Vëzhguesit nuk duhet të kenë kontakt fizik me materialet e votimit.


Në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk duhet cënuar mundësia e vëzhguesve për të ndjekur nga afër

procesin e numërimit dhe shfaqjen e fletëve të votimit në monitorët e vendosur, për këtë qëllim.





# PLAN VENDOROSJE ORIENTUERE E VENDIT TE NUMERIMIT TE VOTAVE





## Kreu II GRUPET E NUMËRIMIT TË VOTAVE

### 1. Caktimi i Grupeve dhe Tavolinave të Numërimit të Votave

KZAZ-ja përcakton Tavolinat e Numërimit dhe Grupet e Numërimit në ZAZ (Tabela 2).

QV	Tavolina	GN
Deri në 30	3	6
31-50	4	8
51-80	5	10
81-100	6	12
101 - 115	7	14
116 - 130	8	16
131-140	9	18
Mbi 140	10	20

Tabela 2

KZAZ-ja, jo më vonë se 15 ditë para ditës së votimit, cakton me vendim ngritjen e Grupeve të Numërimit në rang ZAZ-je dhe përdor MODEL– 08V KZAZ, "Për caktimin e Grupeve të Numërimit të Votave".

- nuk mund të caktojë më pak se gjashtë dhe më shumë se njëzet Grupe të Numërimit të Votave, për numërimin e votave në rang ZAZ-je.
- numëron tavolinat e numërimit të votave, në rend rritës.
- numëron GNV-ve me numër rendor rritës dhe numri i fundit rendor është gjithmonë numër çift.

Kujdes! GNV janë 2 për çdo tavolinë numërimi.

Një grup numërimi numëron jo më pak se 5 dhe jo më shumë se 10 qendra votimi.

Numri i Grupeve të Numërimit të Votave, të cilat angazhohen në të njëjtën kohë për numërimin e votave në VNV nuk mund të jetë më pak se tre dhe me shumë se dhjetë.

- Grupi i dytë i Numërimit fillon punë menjëherë pas përfundimit të procesit nga grupi i parë i numërimit.
- Grupet e dytatë Numërimit të Votave, në çdo rast, rrinë në gadishmëri dhe me vendim të KZAZ-së zëvendësojnë menjëherë grupet e para, edhe nëse grupet e para ndërpresin punën për shkak të papërligjura.
- Nëse nuk është e nevojshme, grupet e dyta nuk futen në punë.

### 2. Paraqitja e propozimeve nga partitë politike për emërimin e anëtarëve të GN-it

KZAZ-ja, njofton me shkrim, 15 ditë para ditës së zgjedhjeve, partitë politike të cilat kanë të drejtë të propozojnë anëtarë të GNV-ve, për numrin e GNV-ve që do të ngrihen dhe u kërkon të dorëzojnë propozimet për emërimin e anëtarëve të GNV-ve, të paktën 12 ditë para ditës së zgjedhjeve.

Propozimet për dy nga anëtarët e Grupeve të Numërimit bëhen nga partitë politike, të cilat kanë propozuar Kryetarin dhe Zv.kryetarin e KZAZ-së.

Propozimet për anëtarin e tretë dhe të katërt të GNV-ve bëhen nga partitë politike që përcaktuara me vendim të KQZ-së.

Propozimet për anëtarë të GNV-ve i paraqiten KZAZ-së. Partitë politike mund t'ju delegojnë degëve lokale të tyre të drejtën e propozimit për anëtarë të GNV-ve. Propozimet për çdo anëtar të GNV-së shoqërohen me dokumentet e mëposhtme:

- Çertifikatë personale ose Fotokopje e letërnjoftimit;
- Kopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë.

Kujdes! KZAZ, jo më vonë se dhjetë ditë ditë para datës së zgjedhjeve, emëron anëtarët e GNV-ve pasi i gjen ato në përputhje me kushtet dhe kriteret e parashikuara në nenin 9 dhe 10 të Udhëzimit të KQZ-së nr.4/2015.

KZAZ-ja përdor MODEL– 09V KZAZ “Për emërimin e anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave”, miratuar me Vendimin e KQZ-së nr.15/2015.

### 3. Procedura e zgjedhjes për numëruesin e parë dhe sekretarin e GNV-ve

KZAZ-ja emëron numëruesin e parë dhe sekretarin e Grupeve të Numërimit sipas procedurës së mëposhtme:

- Partia politike, e cila ka propozuar zëvendëskryetarin e KZAZ-së, ka të drejtën të paraqesë propozime për numëruesin e parë të grupeve “tek” të numërimit të votave dhe sekretarin e grupeve “çift” të numërimit të votave.
- Partia politike, e cila ka propozuar kryetarin e KZAZ-së, ka të drejtën të paraqesë propozime për numëruesin e parë të grupeve “çift” të numërimit të votave dhe sekretarin e grupeve “tek” të numërimit të votave.
- Anëtari i tretë dhe i katërt i Grupeve të Numërimit emërohen nga propozimet e partive politike, të cilave i ka lindur e drejta të propozojnë anëtarin e tretë dhe të katërt, sipas shortit të hedhur në KQZ, për çdo ZAZ.

### 4. Zëvendësimi i anëtarëve të Grupit të Numërimit

- Në rast se, një parti politike nuk paraqet propozim brenda afatit kohor, KZAZ-ja me vendim cakton anëtarët zëvendësues.
- Partia politike, e cila ka të drejtën të paraqesë propozimin për anëtarin e tretë ose të katërt të GNV-ve, sipas shortit të hedhur në KQZ dhe nuk ka anëtarë në KQV, humbet të drejtën të paraqesë anëtar të GNV-ve nëse nuk respekton afatin e parashikuar në nenin 8/1 të Udhëzimit 4/2015.
- Anëtarët zëvendësues caktohet me short ndërmjet anëtarëve të KQV-ve që i përkasin të njëjtit grupim politik në Zonën e Administrimit Zgjedhor.
- Në rast se nuk është i mundur plotësimi i numrit të anëtarëve të Grupit të Numërimit të Votave, ai funksionon me jo më pak se dy anëtarë.

### 5. Procedura e shortit për zëvendësimin e anëtarëve të GNV-ve

Anëtari zëvendësues i GNV-ve, caktohet nga KZAZ-ja, mbi bazën e rezultatit të shortit, të hedhur sipas kësaj procedure:

Sekretari i KZAZ-së përzgjedh të gjithë anëtarët e KQV-ve të cilët plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 9 dhe në nenin 10 të Udhëzimit të KQZ-së nr.4/2015.

- Anëtarët e KQV-ve renditen, në mënyrë rastësore, në lista sipas partive politike të cilat i kanë propozuar.

- Çdo emri, të renditur në secilën listë, i vendoset nga një numër rendor rritës, duke filluar nga 01.
- Në një enë transparente, vendosen shirita letre ku janë shënuar numrat rendor që i korrespondojnë çdo anëtar të KQV-së të partisë politike përkatëse të renditur në listë.
- Kryetari i KZAZ-së tërheq shirita letre në numër të barabartë me numrin e anëtarëve të GNV-ve që mungojnë.
- Anëtar i KQV-së, i emëruar me propozim të partisë politike, për të cilën hidhet shorti, të cilit i korrespondon numri rendor i shënuar në shiritin e letrës së tërhequr, caktohet anëtar i Grupit të Numërimit.
- Në rast se partia politike, e cila nuk ka paraqitur propozime për anëtar të GNV-ve dhe nuk ka anëtar në KQV i përket partive të shumicës parlamentare, shorti hidhet ndërmjet anëtarëve të KQV-së, që i përkasin partisë së dytë të shumicës parlamentare e cila ka propozuar anëtar në KQV.
- Në rast se partia politike, e cila nuk ka paraqitur propozime për anëtar të GNV-ve dhe nuk ka anëtar në KQV i përket partive të opozitës parlamentare, shorti hidhet ndërmjet anëtarëve të KQV-së, që i përkasin partisë së dytë të opozitës parlamentare e cila ka propozuar anëtar në KQV.

6. Kur vendi i një anëtar i Grupit të Numërimit mbetet vakant gjatë procesit të numërimit të votave, partia politike e cila kishte propozuar anëtarin, paraqet menjëherë propozimin e ri.

- Nëse partia politike përkatëse nuk paraqet propozimin për plotësimin e vendit të mbetur vakant, GNV vazhdon numërimin kur anëtarët në detyrë nuk janë më pak se dy.
- Nëse nga vakancat e krijuara GNV-ja mbetet me më pak se dy anëtarë, për plotësimin e vakancave KZAZ-ja zbaton procedurat e shortit të përcaktuara në nenin 14 të Udhëzimit të KQZ-së nr.4/2015.

### KREU III - DËRGIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE NGA KQZ PËR KZAZ, KQV dhe GN

#### 1. Dorëzimi i materialeve zgjedhore në KZAZ

KQZ-ja dërgon në KZAZ, jo më vonë se 3 ditë para datës së zgjedhjeve, materialet zgjedhore të futura në kuti të veçanta ambalazhi (me përjashtim të dhomave të fshehtësisë, që dorëzohen më vete), sipas etiketave përkatëse (shënjën dalluese për identifikimin KZAZ-së, qarkun):

- Kutitë e veçantë me materiale zgjedhore, që administrohet vetëm nga KZAZ-ja ku përfshihen edhe materialet zgjedhore për grupet e numërimit



Procesverbalet që përdoren për dorëzimin e materialeve zgjedhore janë sipas modeleve, si më poshtë:

PV - KZAZ - 02	Materialet zgjedhore për KZAZ-në dhe dokumentacionin zgjedhor, me të cilin dorëzohen:
Model 39-15	Tabelë përmbledhëse e rezultateve për bashkinë, për kryetarin;
Model 39-15-P	Tabelë përmbledhëse provizore e rezultateve për bashkinë, për kryetarin;
Model 40-15	Tabelë përmbledhëse e rezultateve për bashkinë, për këshillin;
Model 56-15	Tabelë e rezultateve për QV-në, për kryetarin e bashkisë;

Model 56-15-G	Tabelë e rezultateve për kryetarin për fletët e votimit të hedhura gabim;
Model 57-15	Tabelë e rezultateve për QV-në, për këshillin e bashkisë;
Model 57-15-G	Tabelë e rezultateve për këshillin për fletët e votimit të hedhura gabim;
Set i zarfave të sigurisë Z.04a, b; Z.05a, b; Z.06a, b; Z07/a, b	
Set i bojës matrikulluese	
Vula (kode) sigurie për GN-të;	
Vula (kode) sigurie rezervë;	
Pinca për këputjen e vulave të sigurisë;	
Makinë llogaritëse;	
Shirit ndarës për VNV-në;	
Bazament (druri) kryq për organizimin e VNV-së;	
Element (druri) ndarës për identifikimin e GN-së;	
❖ Paketa e materialeve zgjedhore (e shoqëruar me fletën e inventar) të dorëzohet në KOZ.	

ZGJEDHJE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE - TË DATËS 21 QERSHOR 2015

Z.04a

KZAZ \_\_\_\_\_ QV nr. \_\_\_\_\_

**ZARFI I FLETËVE TË VOTIMIT TË KONTESTUARA PËR KANDIDATËT PËR KRYETAR BASHKIE**

Sel-retari \_\_\_\_\_ Numërimi i Partë \_\_\_\_\_

ZGJEDHJE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE - TË DATËS 21 QERSHOR 2015

Z.05a

KZAZ \_\_\_\_\_ QV nr. \_\_\_\_\_

**ZARFI I FLETËVE TË VOTIMIT TË PAVLEFSHME PËR KANDIDATËT PËR KRYETAR BASHKIE**

Sel-retari \_\_\_\_\_ Numërimi i Partë \_\_\_\_\_

ZGJEDHJE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE - TË DATËS 21 QERSHOR 2015

Z.06a

KZAZ \_\_\_\_\_ QV nr. \_\_\_\_\_

**ZARFI I FLETËVE TË VOTIMIT TË PAVLEFSHME PËR KANDIDATËT PËR KRYETAR BASHKIE**

Sel-retari \_\_\_\_\_ Numërimi i Partë \_\_\_\_\_


ZGJEDHJE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE - TË DATËS 21 QERSHOR 2015

Z.07a

KZAZ \_\_\_\_\_ QV nr. \_\_\_\_\_

**ZARFI I FLETËVE TË VOTIMIT PËR KRYETARIN - TË HEDHURA GABIM NË KËPUTJE E KËSHILLIT BASHKIAK**

Sel-retari \_\_\_\_\_ Numërimi i Partë \_\_\_\_\_



## Dokumentacioni i punës së KZAZ-së dhe GNV-ve

MODEL–01PV KZAZ	Procesverbal i vulosjes, përpara fillimit të numërimit, të kutisë së posaçme për fletët e votimit të hedhura gabim në kutitë e votimit për kryetar bashkie;
MODEL-02PV KZAZ	Procesverbal i vulosjes, përpara fillimit të numërimit, të kutisë së posaçme për fletët e votimit të hedhura gabim në kutitë e votimit për këshillin bashkiak;
PV-GNV-10	Procesverbal i GNV për mbylljen e kutisë së materialeve zgjedhore.
MODEL–03PV KZAZ–GN	Procesverbal konstatimi i GNV për dorëzimin në KZAZ të zarfave të mbyllur me “VOTA TE HEDHURA GABIM”
MODEL–04PV KZAZ–GN	Procesverbal i GNV për pasqyrimin e numrit të përgjithshëm të fletëve të votimit të kontestuara.
Model PV 05 KZAZ-GNV	Procesverbal i mbylljes së kutisë së posaçme me fletët e votimit të hedhura gabim në kutitë e votimit për kryetarin e bashkisë;
Model PV 06 KZAZ-GNV	Procesverbali mbylljes së kutisë së posaçme me fletët e votimit të hedhura gabim, në kutitë e votimit për këshillin bashkiak;
Model 39-15-V	Vendim i KZAZ-së për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për bashkinë, për zgjedhjen e kryetarit;
Model 40-15-V	Vendim i KZAZ-së për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për bashkinë, për zgjedhjen e këshillit.

➤ PV - KZAZ - 03, materialet zgjedhore që dorëzohen në KZAZ për KQV-të (n. 99, n. 100/1)

✓ Procesverbal i vulosjes së kutive të votimit/për hapjen e votimit, Model-PV-KQV-07, +Zarfi, Z 01;

✓ Procesverbal i mbylljes së votimit, Model-PV-KQV-08, +Zarfi, Z 01;

- ✓ Vulat e KQV-së;
- ✓ Vulat për kryetarët e KQV-ve;





№ Kuti votimi për:

KRYETAR BASHKIE

KËSHILLIN BASHKIAK



- Kutia e Materialeve Zgjedhore/të Votimit;
- Vula (kode) sigurie;
- Set i zarfave të sigurisë:
  - Zarf i procesverbalit të vulosjes së kutisë së votimit, Z.01;
  - Zarf i fletëve të votimit të papërdorura, Z.02;
  - Zarf i fletëve të votimit të dëmtuara Z.03
- Set i bojës matrikulluese;
- Dhoma të fshehtësisë;
- Dhoma të fshehtësisë për personat me aftësi të kufizuar;
- Paketë kancelerike e materialeve zgjedhore.
- Libri i protokollit të mbledhjeve të KQV-së;
- Regjistri i posaçëm i zgjedhësve.



➤ PV - KZAZ – 04 - për dorëzimin e fletëve të votimit për çdo KQV, i cili mbahet në dy kopje dhe firmoset nga dorëzuesi (punonjësi i KQZ-së) dhe nga marrësi (kryetar, zv.kryetar, sekretar i KZAZ-së).

Ky procesverbal (model PV - KZAZ – 04), përmban numrin e fletëve të votimit që i dorëzohen KZAZ-së, e cila i shpërndan për çdo QV në juridiksionin e saj:

Fletë votimi për kandidatët për:

KRYETAR BASHKIE

KËSHILLIN BASHKIAK

FLETË VOTIMI	
Zgjedhjet për kryetar të bashkisë, 21.09.2015	
KANDIDATËT PËR KRYETAR	
1	EMRI ATËSIA MBIEMRI Partia Xhërtul FX
2	EMRI ATËSIA MBIEMRI Koalicioni I PLF, LKS, PZGG, PVL, PQ, PES ADP
3	EMRI ATËSIA MBIEMRI Koalicioni II PLF, LKS, PZGG, PVL, PQ, PES QRS
4	EMRI ATËSIA MBIEMRI Partia Xhërtul FX
5	EMRI ATËSIA MBIEMRI Kandidat i propozuar nga zgjedhësit

FLETË VOTIMI	
Zgjedhjet për këshillin bashkiak, 21.09.2015	
KANDIDATËT PËR KËSHILLIN	
1	EMRI ATËSIA MBIEMRI Partia Xhërtul FX
2	EMRI ATËSIA MBIEMRI Koalicioni I PLF, LKS, PZGG, PVL, PQ, PES ADP
3	EMRI ATËSIA MBIEMRI Koalicioni II PLF, LKS, PZGG, PVL, PQ, PES QRS
4	EMRI ATËSIA MBIEMRI Partia Xhërtul FX
5	EMRI ATËSIA MBIEMRI Kandidat i propozuar nga zgjedhësit

Kujdes:

Në PV-KZAZ-04 duhet të shënohen numrat e serisë së bllokut të fletëve të votimit. Numri i fletëve të votimit për subjektet zgjedhore, do të jetë i barabartë me numrin e zgjedhësve të regjistruar në atë qendër votimi, së bashku me fletët shtesë, duke i shtuar 2%. KZAZ-ja verifikon numrat e serisë të vendosura në dokumentin që shoqëron bllokun e ambalazhuar. Ju mund t'i referoheni KZ, 97/4, 98/2 dhe n.99/1, sh."a".

## 2. Dorëzimi i materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja në çdo KQV

KZAZ:

- Njofton çdo KQV për kohën e marrjes së materialeve zgjedhore, duke patur parasysh largësinë e saj nga vendndodhja e KZAZ-së,
- Merr masat për sigurimin e automjeteve për transportimin e materialeve zgjedhore për çdo KQV.

KZAZ-ja shpërndan materialet zgjedhore për çdo QV në juridiksionin e saj jo më vonë se 15 orë para Hapjes së Votimit.

KZAZ i shpërndan të gjitha materialet e sipërhënuara në PV-KZAZ-03 dhe PV-KZAZ-04 me procesverbal, model PV-KQV-05, përveç vulave metalike me kodet e sigurisë, të cilat jepen me procesverbal model PV-KZAZ-06.

### 2.1 Materiale zgjedhore jashtë kutisë, të cilat i dorëzohen KQV-së nga KZAZ-ja:

1. Lista e zgjedhësve të QV-së (me procesverbal të përgatitur nga KZAZ);
2. Vulat metalike me kodet e sigurisë për: kutitë e votimit dhe kutinë e materialeve zgjedhore/të votimit;
3. Vula e KQV-së e vendosur në një zarf të mbyllur (e vulosur nga Ministria e Brendshme)
4. Vula për Kryetarin e KQV-së



### 2.2 Procedura për dorëzimin e vulës së kryetarit të KQV-së

Kryetari i KQV-së përkatëse në praninë e anëtarëve të KZAZ-së, kryen sipas radhës veprimet e mëposhtme:

- merr me zgjedhje rastësore një vulë nga grumbulli përkatës i vulave të paketuara.
  - gris ambalazhin e vulës,
  - vulos, në një letër të bardhë, modelin e krahasimit të vulës,
  - shënon me shkrim dore emrin dhe mbiemrin e tij, si dhe nënshkruan poshtë vulës në prani të anëtarëve të KZAZ-së.
- Anëtarët e KZAZ-së nënshkruajnë në pjesën e pasme të letrës së bardhë me modelin krahasues (specimeni) të Vulës së Kryetarit të KQV-së dhe mbahet në ruajtje nga Sekretari i KZAZ-së në një dosje të veçantë së bashku me Modelin PV-KZAZ-06.



Kujdes:

Numri i fletëve të votimit të marra në dorëzim të regjistrohet i saktë në Procesverbalin model PV-KQV-05.

Numrat e vulave me kodet e sigurisë shënohen në Procesverbalin, model PV-KZAZ-06.

Pajisni KQV-të edhe me Procesverbalet model:

PV-KQV-07, PV-KQV-08, PV-KZAZ-09, si dhe çdo material tjetër zgjedhor.

TË GJITHA MODELET E PROCESVERBALEVE I GJENI NË FLETOREN E PUNËS 2

### 3. Materialet zgjedhore për GN-të

Materialet që i dërgohen KZAZ-së për GNV-të përcaktohen sipas një inventari, të ndara, si vijon:

#### A. Dokumentacioni i punës:

- Kod Zgjedhor;
- Manual;

MODELI	Përmbajtja e Procesverbalit
PV-GNV-10	Procesverbal i GNV për mbylljen e kutisë së materialeve zgjedhore;
Model- 03PV KZAZ-GNV	Procesverbal konstatimi i grupit të numërimit të votave për dorëzimin në KZAZ të zarfave me fletët e hedhura gabim "VOTA TE HEDHURA GABIM";
MODEL-04PV KZAZ-GN	Procesverbal i grupit të numërimit të votave për pasqyrimin e numrit të përgjithshëm të fletëve të votimit të kontestuara;
Model PV 05 KZAZ-GNV	Procesverbal i mbylljes së kutisë së posaçme me fletët e votimit të hedhura gabim në kutitë e votimit për kryetarin e bashkisë;
Model PV 06 KZAZ-GNV	Procesverbal i mbylljes së kutisë së posaçme me fletët e votimit të hedhura gabim, në kutitë e votimit për këshillin bashkiak.
Model 56-15	Tabelë e rezultateve për QV-në, për kryetarin e bashkisë;
Model 56-15-G	Tabelë e rezultateve për kryetarin për fletët e votimit të hedhura gabim;
Model 57-15	Tabelë e rezultateve për QV-në, për këshillin e bashkisë;
Model 57-15-G	Tabelë e rezultateve për këshillin për fletët e votimit të hedhura gabim;

#### B. Set i kancelarive:

- Shenjë dalluese për GN;
- Pincë për këputjen e kodeve të sigurisë;
- Dokument identifikimi;
- Kode/vula metalike;
- Makinë llogaritëse;
- Stilolaps;
- Letër A4;
- Zarfi i fletëve të votimit të vlefshme për çdo subjekt, kandidatin për Kryetar Bashkie, Z.06a;
- Zarfi i fletëve të votimit të kontestuara kandidatin për Kryetar Bashkie, Z.04a;
- Zarfi i fletëve të votimit të pavlefshme për kandidatin për Kryetar Bashkie, Z.05a;
- Zarfi i fletëve të votimit për kandidatin për Kryetar, të hedhura gabim në kutinë e Këshillit, Z07/a;
- Qirinj;

Kujdes: Mund t'i referoheni Vendimeve të KQZ-së nr.15/2015 dhe 18/2015, Udhëzimit nr.5, dt.12.03.2009 (listës përbërëse të Aneksit 1) nenet 7/9/10 /"a"/ "b"

#### KREU IV-VEPRIME TË KZAZ-së GJATË DITËS SË ZGJEDHJEVE

##### 1. Veprime të KZAZ-së gjatë ditës së zgjedhjeve,

KZAZ-ja :

- drejton procesin zgjedhor nga ambienti i caktuar si VNV;
- përgatit një plan konkret (me afate kohore të përcaktuara), në funksion të ndjekjes dhe monitorimit të procesit zgjedhor në të gjitha QV-të e përfshira në territorin ZAZ-së përkatëse, në të cilin parashikon:
  - marrjen e informacionit për hapjen e QV-së,
  - paraqitjen në detyrë të anëtarëve të KQV-së,
  - problemet që shfaqen në QV;
- cakton grupe pune me dy anëtarë (pozitë, opozitë) për mbikqyrjen e procesit dhe zgjidhjen e problemeve që njoftohen nga KQV-ja.
- mban kontakte të vazhdueshme me KQZ-në dhe jep informacion në lidhje me:
  - fillimin dhe ecurinë e procesit të votimit;
  - pjesëmarrjen në votime, numrin e përgjithshëm të zgjedhësve që kanë votuar në QV çdo tri orë deri në ora 19.00;
  - plotësimin e vendeve vakant, të krijuara në KQV gjatë ditës së votimit, e tjera;
- merr vendim, MODEL-10V KZAZ, për caktimin e qendrës së votimit për votimin e anëtarëve dhe sekretarit të KZAZ-së, si dhe i pajis me vërtetim të posaçëm, MODEL- O6R KZAZ, secilin prej tyre (në vërtetimin shënohet edhe vendndodhja e QV-së);
- shqyrton menjëherë ankesat e paraqitura nga subjektet zgjedhore apo nga anëtarë të KQV-së, në rastet kur KQV-ja nuk ka arritur të marrë vendim brenda afateve kohore përkatëse lidhur me ecurinë e procesit të votimit. KZAZ, për çdo rast merr vendimin përkatës dhe e përcjell atë menjëherë në KQV për zbatim dhe një kopje në KQZ.
- Drejton transportin e materialeve zgjedhore nga anëtarët e KQV-së, menjëherë pas mbylljes së votimit;

Kujdes: Në çdo rast në KZAZ duhet të jenë të pranishëm 4 anëtarët e tjerë të saj, pozitë-opozitë, me të drejtë vote

Kujdes! Kryetari i KZAZ-së

Drejton punën e KZAZ-së, së bashku me zv.kryetarin e KZAZ-së, për mbikqyrjen e procesit zgjedhor gjatë ditës së zgjedhjeve (cakton grupe pune, me dy anëtarë, për verifikimin dhe zgjidhjen e problemeve që njoftohen nga KQV-ja);

Udhëzimet e KQZ-së nr.2, dt.25.02.2009, n.2 dhe nr. 2, datë 4.03.2015, n.12/2/shkronja "gj".

Përcjell menjëherë kërkesën organeve të Policisë së Shtetit, në rast të incidenteve të njoftuara nga KQV-ja; KZ, Vendimi nr. 176, datë 19.03.2013, n. 7/5

##### 2. Transmetimi i informacionit ditën e votimit

- ✓ Menjëherë pas hapjes së votimit Sekretari i KQV-së njofton KZAZ-në përkatëse për orën e saktë të hapjes dhe në raste vonese tej orës së përcaktuar me ligj, njofton dhe arsyen e vonesës.

- ✓ Nëse gjatë ditës ndodh pezullimi i votimit, sekretari i KQV-së njofton menjëherë KZAZ-në përkatëse për orën e pezullimit të votimit, arsyen dhe orën e rihapjes së votimit.
- ✓ Sekretari i KQV-së çdo tre orë, pas orës 7:00 të hapjes së votimit, njofton KZAZ-në përkatëse për numrin e zgjedhësve që kanë votuar deri në atë moment. Në mbylljen e votimit sekretari i KQV-së njofton numrin e përgjithshëm të zgjedhësve që kanë votuar në atë QV dhe përkatësinë gjinore të tyre.
- ✓ Sekretari i KZAZ-së hedh menjëherë, në kompjuterin përkatës në VNV, informacionin e marrë nga sekretarët e KQV-ve si më sipër dhe e transmeton atë në KQZ. Në mbylljen e votimit njoftohen dhe shifrat me përkatësinë gjinore të atyre që kanë votuar.

**Kujdes!** Sekretari i KQV-së menjëherë pas hapjes së votimit njofton KZAZ-në përkatëse për orën e saktë të hapjes dhe në raste vonese tej orës së përcaktuar me ligj, njofton dhe arsyen e vonesës.

Nëse gjatë ditës ndodh pezullimi i votimit, sekretari i KQV-së njofton menjëherë KZAZ-në përkatëse për orën e pezullimit të votimit, arsyen dhe orën e rihapjes së votimit.

Në njoftimin e fundit (pas mbylljes së votimit), pra jo më vonë se ora 19<sup>00</sup>, KZAZ njofton në KQZ:

Ñ numrin e përgjithshëm të zgjedhësve që kanë votuar në atë QV;

Ñ numrin/shifrën e përgjithshëm të femrave që kanë votuar.

Transmetimi i informacionit nga KQV-të në KZAZ-të gjatë ditës së votimit të jepet me mesazh zanor me anë të telefonit celular, ndërsa transmetimi i informacionit nga KZAZ-të në KQZ bëhet elektronikisht nëpërmjet rrjetit që lidh VNV-të me serverin e KQZ-së.

**Kujdes:**

Mosdërgimi i informacionit ngarkon me përgjegjësi Sekretarin e KZAZ-së.

Ju mund t'i referoheni vendimit të KQZ-së nr.13, dt.27.01.2015 "Për miratimin e procedurave për mbledhjen, administrimin dhe publikimin e informacionit ditën e votimit".

Partitë politike, bashkë me propozimin për emrat e anëtarëve të KQV-ve, që do të jenë Sekretarë të KQV-ve depozitojnë edhe numrin e celularit të tyre.

## KREU V-MARRJA NË DORËZIM E MATERIALEVE TË SJELLA NGA KQV NË VNV

### 1. Dërgimi i materialeve zgjedhore nga KQV në VNV

Kutitë e Votimit me fletët e votimit, Kutia e Materialeve të Votimit dhe dhomat e fshehtësisë, dorëzohen në VNV përkatëse sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 3 orë nga mbyllja e votimit në QV.

Dërgimi në KZAZ(VNV) i kutive të votimit me fletët e votimit dhe i kutisë së materialeve të votimit bëhet me automjetin e siguruar për transport nga KZAZ-ja.

Dërgimi i tyre bëhet nga:

kryetari, sekretari i KQV-së, dhe anëtarët e KQV-së në qoftë se dëshirojnë, si dhe një punonjës policie, i cili ka detyrë të garantojë shoqërimin dhe mos prekjen e kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutisë së materialeve të votimit.

**Kujdes:** Ju mund t'i referoheni KZ, nenit 114/2



## 2. Ngritja e Grupeve të marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore

Pas mbylljes së procesit të votimit, KZAZ-ja ngre dhe organizon në VNV:

-një ose më shumë grupe të marrjes (i përbërë nga 2 anëtarë të saj, të propozuar përkatësisht nga kryetari dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së) në dorëzim të materialeve zgjedhore/të votimit të sjella nga KQV-të.

Grupet e Marrjes në Dorëzim të KZAZ-së përkatëse, marrin në dorëzim nga Kryetari, dhe Sekretari i çdo KQV-je, sipas procesverbalit, Model PV-KZAZ-09:

- a. Kutitë e votimit me fletët e votimit;
- b. Kutinë me materialet e votimit;
- c. Dhomat e fshehtësisë.

Kujdes:

Nëse është e nevojshme, KZAZ cakton dy persona në ndihmë për çdo grup të marrjes në dorëzim, nga lista e anëtareve të GNV-ve, të cilët merren kryesisht me sistemimin e kutive nën drejtimin e KZAZ-së. Në caktimin e tyre duhet patur parasysh përkatësia politike dhe baraspeshimi shumicë-opozitë.

Propozimet për caktimin e këtyre dy personave bëhen nga kryetari dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së.

Grupet e marrjes në dorëzim, në asnjë rast nuk mund të refuzojnë marrjen në dorëzim të kutive të votimit, kutisë së materialeve të votimit apo materialeve të tjera të logjistikës zgjedhore, të cilat vijnë në VNV nga KQV-të, në juridiksionin e KZAZ-së përkatëse.

Ju mund t'i referoheni Udhëzimit nr.5, datë 22.04.2015, neni 4.

## 3. Detyrat e grupit të marrjes në dorëzim

Grupi i marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore:

- funksionon vetëm për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore të sjella nga KQV-të në VNV.
- merr në dorëzim kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutinë me materialet e votimit të çdo QV-je, sapo ato mbërrijnë në VNV.
- në asnjë rast nuk mund të refuzohet marrja në dorëzim e kutive të votimit me fletët e votimit, të kutisë me materialet e votimit të çdo QV-je apo materialeve të tjera të logjistikës zgjedhore të cilat dorëzohen nga KQV-të në VNV.

## 4. Marrja në dorëzim të materialeve zgjedhore të sjella nga KQV-ja në VNV

Gjatë procesit të marrjes në dorëzim të bazës materiale zgjedhore, grupi i marrjes në dorëzim ndjek këtë procedure:

- Merr nga sekretari i KZAZ-së, dosjen e KQV-së përkatëse, e cila është plotësuar gjatë dhënies së bazës materiale zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV, e cila përmban:
  - Procesverbalin Model PV-KZAZ-06 dhe
  - modelin krahasues të vulës së kryetarit të KQV-së.
- Shënon në Procesverbalin PV-KZAZ-09 numrat e kodeve të sigurisë të vulave me të cilat janë mbyllur kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit;
- Verifikon në çast nëse:

\*përputhen numrat e kodeve të sigurisë së vulave me të cilat janë mbyllur kutitë e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, me numrat e kodeve të sigurisë të vulave të shënuara në Procesverbalin e dorëzimit të kodeve të sigurisë të vulave, Model PV- KZAZ-06, nga KZAZ-ja në KQV;

\* vendosja e vulave me kode sigurie është bërë në mënyrë të tillë, që lejon hapësira midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj;

\* mungojnë ose janë këputur një ose më shumë vula me kodesigurie;

\* kutia, në trupin apo në kapakun e saj:

a. ka thyerje ose çarje, që lejojnë futjen apo nxjerrjen e fletëve të votimit apo materialit tjetër të votimit.

b. është e llojit, formës ose përmasave të ndryshme nga ato të përcaktuara me vendimin e KQZ-së.

Pasi kanë përfunduar procesin e verifikimit të

Kutive të Votimit dhe Kutisë së Materialeve të Votimit, Anëtarët e Grupit të Marrjes në Dorëzim veprojnë si më poshtë:

-Shënojnë në Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim, Model PV-KZAZ-09:

a. numrat e kodeve të sigurisë, me të cilat janë mbyllur kutitë e votimit dhe kutia e materialeve të votimit, duke i krahasuar me procesverbalin Model PVKZAZ-06.

Pas dorëzimit të materialeve të Votimit në KZAZ, anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim, kryetari i KQV-së, sekretari i KQV-së nënshkruajnë Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim Model PV-KZAZ-09.

Punonjësi i Policisë firmos në këtë procesverbal vetëm për shoqërimin, garantimin dhe mosprekjen e kutive të votimit nga QV në VNV (pas firmosjes nga KZAZ-ja dhe KQV-ja).

Procesverbali hartohet në 4 kopje dhe vulozet nga Sekretari i KZAZ-së.

Një kopje e Procesverbalit të marrjes në dorëzim Model PV- KZAZ-09, i jepet:

Ñ KQV-së, kryetarit dhe sekretarit të saj;

Ñ policit shoqërues, i cili dorëzohet së bashku me raportin e shërbimit në komandën e strukturës, ku ai bën pjesë;

Ñ KQZ-së, sëbashku me dokumentacionin zgjedhor, sapo dorëzohet baza materiale zgjedhore; dhe

Ñ KZAZ-së, e cila administron origjinalin e Procesverbalit.

Kujdes:

Origjinali i Procesverbalit të marrjes në dorëzim, Model PV- KZAZ-09, administrohet nga KZAZ-ja.

Me marrjen në dorëzim nga KQV-të të kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutive me materialet e votimit, KZAZ-ja, sekretari i KZAZ-së porosit operatorin të njoftojë në rrugë elektronike KQZ-në për:

Ñ rregullsinë e tyre

dhe

Ñ kutitë e parregullta, nëse ka.

Sekretari i KZAZ-së i jepet dhënat operatorit që t'i hedh në formën përkatëse në kompjuter

Ju mund t'i referoheni KZ, neni 115/7, Udhëzimit nr.5, datë 22.04.2015, neni 6/ "f"/"g"/"h"/ "i".

## 5.Konstatimi dhe Deklarimi i Kutive të Parregullta

Në rast se gjatë procesit të marrjes në dorëzim të kutive me fletët e votimit dhe kutisë së materialeve të votimit, konstatohet një apo më shumë parregullsi, si:

- mospërputhjeje të numrave të kodeve të sigurisë të vulave me Procesverbalin, Model PV-KZAZ-06;
- hapësirë midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj;
- një ose më shumë vula me kode sigurie mungojnë ose janë këputur;
- kutia, në trupin apo në kapakun e saj ka:
  - thyerje ose çarje, që lejojnë futjen apo nxjerrjen e fletëve të votimit apo materialit tjetër të votimit.
  - është e llojit, formës ose përmasave të ndryshme nga ato të përcaktuara me vendimin e KQZ-së.

Grupi i marrjes në dorëzim, njofton menjëherë KZAZ-në për parregullsinë dhe i kërkon asaj, që kutia përkatëse të shënohet "KUTI E PARREGULLT".

Anëtarët e KZAZ-së përkohësisht ndërpresin punën e tyre në këto grupe,

- paraqiten tek vendi i dorëzimit të kutive përkatëse të votimit me fletët e votimit dhe kutive të materialeve të votimit.
  - verifikojnë parregullsinë e konstatuar,
  - marrin vendim, duke e vlerësuar kutinë/kutitë si të parregullt,
  - i vendosin etiketën "KUTI E PARREGULLT"
- dhe
- e vendosin në këndin e kutive të parregullta;

**Kujdes!**

Në rast se Grupi i Marrjes në Dorëzim konstaton:

mospërputhjeje të numrave të kodeve të sigurisë të vulave, informon menjëherë KZAZ-në për mospërputhjen dhe i kërkon asaj që kutia të shënohet "KUTI E PARREGULLT".

KZAZ-ja verifikon menjëherë mospërputhjen e konstatuar/ parregullsinë dhe merr vendim për vlerësimin e kutisë. Udhëzimi i KQZ-së nr.5, datë 22 .04.2015, neni 6/"c2"/" ë"/"f".

Mospërputhjet (të gjitha) e konstatuara shënohen nga

- grupi i marrjes në dorëzim në Procesverbalin e Marrjes në Dorëzim, model PV-KZAZ-09 dhe nga

• KZAZ-ja në Librin e Protokollit të Mbledhjeve dhe Procesverbalin e Konstatimit, Udhëzimi i KQZ-së nr.5, datë 22 .04.2015, neni 6/"c3"/ "f"/ g".

KZAZ-ja, kur konstaton parregullsitë sipas pikave "c","ç","d","dh", "e" të nenit 6 të Udhëzimit i KQZ-së nr.5, datë 22.04.2015 vlerëson kutinë si të parregullt, i vendos etiketën "KUTI E PARREGULLT" dhe porositi menjëherë operatorin ta hedhë këtë fakt në sistemin elektronik. Udhëzimi i KQZ-së nr.5, datë 22.04.2015, neni 6/"f".

Në rast se:

- a. të dy kutitë e votimit me fletët e votimit janë vlerësuar "KUTI E PARREGULLT", atëherë kutitë me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit vendosen në këndin e kutive të parregullta.

**Kujdes!**

Kutitë e votimit, të përcaktuara si "KUTI E PARREGULLT", në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk hapen nga KZAZ-ja dhe nuk i kalojnë GNV-ve për vlerësim. Këto kuti, dërgohen në KQZ, së bashku me kutinë e materialeve të votimit për nevoja të hetimit administrativ.

b. vetëm njëra nga kutitë e votimit me fletët e votimit është vlerësuar "KUTI E PARREGULLT", atëherë vetëm kjo kuti dërgohet në këndin e kutive të parregullta, ndërsa kutia tjetër e votimit me fletët e votimit e marrë në dorëzim e rregullt do t'i nënshtrohet procedurave të hapjes dhe numërimit së bashku me kutinë e materialeve të votimit, sipas KZ, nenet 116-119.

c. kutitë me fletët e votimit janë marrë në dorëzim të rregullta dhe kutia e materialeve të votimit është vlerësuar nga KZAZ-ja "KUTI E PARREGULLT", ajo i nënshtrohet procedurave të hapjes dhe vlerësimit së bashku me kutitë e votimit me fletët e votimit.

Në çdo rast, parregullsitë që kanë çuar në vlerësimin e kësaj kutie si "KUTI E PARREGULLT", shënohen në Librin e Protokollit të Mbledhjeve dhe në Procesverbalin e Konstatimit.

**Kujdes!**

Kutia e votimit me fletët e votimit e vlerësuar si "KUTI E PARREGULLT", në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk hapet nga KZAZ-ja dhe nuk i kalon GN-it për vlerësim.

Ju mund t'i referoheni Udhëzimit të KQZ-së nr. 5, datë 22 .04.2015, neni 7

## 6. Sistemimi i kutive të votimit dhe materialeve të votimit në VNV

KZAZ-ja, cakton paraprakisht vendin ku do të vendosen kutitë e votimit dhe kutitë me materialet e votimit, para dhe pas numërimit, sipas Planvendosjes Orientuese, si dhe një hapësirë për kutitë e votimit të vlerësuara "KUTI E PARREGULLT".

Sapo kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë me materialet e votimit, janë marrë në dorëzim nga grupet e marrjes në dorëzim, ato vendosen në vendin e caktuar.

KZAZ-ja mbikqyr këtë proces.

**Kujdes! Kryetari i KZAZ-së, së bashku me zv.kryetarin:**

Drejton dhe kontrollon procesin e marrjes në dorëzim të kutive të votimit me fletët e votimit dhe kutive të materialeve të votimit nga KQV-ja në KZAZ.

Kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit renditen sipas numrit të Qendrës së Votimit.

Qendrat e votimit renditen sipas rendit rritës të tyre

E para në rradhë sipas renditjes së mësipërme, duhet të jetë QV-ja me numër rendor më të vogël dhe e fundit QV-ja me numër rendor më të madh.

QV-të bija vendosen menjëherë pas QV-së mëmë.

**Kujdes!**

KZAZ-ja i vendos kutitë e votimit me fletët e votimit të grupuara, sipas organit përkatës:

Ñ kryetar bashkie,

Ñ këshill bashkiak. Udhëzimi i KQZ-së nr.5/2015, neni 8.

- Fillimisht, në rreshtin e parë, rendit në rend rritës kutitë e votimit për kryetarin e bashkisë;
- Në rreshtin e dytë rendit në rend rritës kutitë e votimit për këshillin bashkiak;
- Në rreshtin e tretë rendit kutitë me materialet e votimit.

Në këtë renditje vendosen kutitë e votimit dhe kutia e materialeve të votimit të çdo QV-je bri njera tjetrës.

**Kujdes:**

Ju mund t'i referoheni nenit 120 të KZ, i ndryshuar (Ligji 31/2015, neni 10), Udhëzimi i KQZ-së nr.5/2015, neni 8.

## KREU VI - VEPRIMET E KZAZ PAS MARRJES NË DORËZIM TË MATERIALEVE ZGJEDHORE

### 1. Veprimet paraprake të KZAZ-së

KZAZ-ja pasi ka marrë në dorëzim bazën materiale të të gjitha QV-ve nën juridiksionin e saj dhe pasi

Kujdes! Ka transmetuar informacionin për:

- Ñ Qendrat e votimit në të cilat zgjedhjet nuk janë zhvilluar, në se ka;
- Ñ Kutitë e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit të cilat janë vlerësuar "KUTI TË PARREGULLTA".

- është siguruar që anëtarët e GNV-ve, kanë marrë trajnimin e nevojshëm, merr masa paraprake për fillimin e procesit të numërimit të votave;
- sigurohet që VNV-ja është gati për fillimin e procesit të numërimit të votave;
- sigurohet që anëtarët e GN-it:
  - ✓ janë prezent në VNV dhe janë të ulur në tavolinat, përkatëse;
  - ✓ janë të pajisur me materialet e nevojshme logjistike;
- Verifikon që personat e pranishëm në VNV janë vetëm personat e autorizuar nga KOZ-ja apo/dhe akredituar nga KOZ-ja ose KZAZ-ja.
- sigurohet që është kryer mbyllja e kutive të posaçme për fletët e votimit të hedhura gabim;
- merr konfirmim nga operatori teknik për funksionimin normal të teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave.

### 2. Fillimi i procesit të numërimit të votave

KZAZ merr vendim për fillimin e procesit të numërimit të votave pasi ka marrë në dorëzim të gjithë bazën materiale, kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit, të QV-ve në juridiksionin e saj.

Sekretari i KZAZ-së shënon në LPM dhe Regjistrin e Vendimeve të KZAZ-së: vendimin dhe orën e saktë të fillimit të procesit të numërimit të votave.

Kujdes! Kryetari i KZAZ-së, së bashku me zv.kryetarin:

Drejton dhe kontrollon procesin e numërimit të votave në VNV; KZ, n.116-122

### 3. Radha e numërimit

Numërimi fillon me votat për kryetarin e bashkisë dhe më pas vijon me numërimin e votave për këshillin bashkiak.

Kujdes! Numërimi i votave për këshillin bashkiak fillon vetëm pasi ka mbaruar numërimi i votave për kryetarin e bashkisë.

### 4. Detyra të KZAZ-së gjatë procesit të numërimit të votave nga GN-të

KZAZ garanton funksionimin korrekt të procesit të numërimit të votave dhe nxjerrjes së Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të zgjedhjeve për Zonën e Administrimit Zgjedhor.



- njofton menjëherë ndihmësit teknikë dhe KQZ-në për defekte të teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave.
- Kur teknologjia mbështetëse e numërimit të votave ka defekt, lejon vëzhguesit e akredituar të subjekteve zgjedhore që nuk kanë anëtar në GNV të afrohen pranë tavolinës së numërimit të votave.
- Shënon në Librin e Protokollit të Mbledhjeve orën e saktë e ndërprerjes dhe rifillimit të funksionimit të teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave.
- Merr vendim për vazhdimin e procedurave të verifikimit të materialit të votimit dhe pezullimin e numërimit të votave nga Grupi i Numërimit, kur verifikon mungesën e procesverbalit të mbylljes së votimit në kutinë e votimit (MODEL PV-KQV-08).
- Pas rivlerësimit nga GNV-ja të votave të kontestuara të QV-së përkatëse, vlerëson votat e kontestuara nga të paktën një anëtar i GNV-së.
- Bën në çast vlerësimin e secilës fletë votimi të kontestuar dhe merr vendim në lidhje me të, duke e vlerësuar atë votë të vlefshme apo votë të pavlefshme. Rezultati i shpallur nga KZAZ-ja shënohet në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së nga Sekretari i KZAZ-së dhe përfshihet në tabelën përkatëse të rezultetit të qendrës së votimit, Model 56-15 apo 57-15, sipas rastit, që harton GNV-ja.
- Në rastet kur GNV, në përfundim të numërimit të kutive përkatëse, dorëzon zarfa me "VOTA TË HEDHURA GABIM",
- KZAZ-ja shënon në Procesverbalin e Konstatimit numrin e fletëve të hedhura gabim për çdo kuti votimi të numëruar nga GN përkatëse.
- ▮ Sekretari i KZAZ hap zarfet, shënon në Librin e Protokollit të Mbledhjeve numrin e QV-së së numëruar, organin për të cilin është votuar në atë kuti, që i korrespondon zarfi përkatës, numrin e fletëve të hedhura gabim të gjendura në secilin zarf, dhe hedh këto vota në kutinë e posaçme përkatëse, pa i hapur fletët e votimit.
- Në rast se, edhe pas numërimi të dytë të votave për subjektin zgjedhor, ka përsëri kundërshtime, numëruesi i parë ose anëtar i kundërshtues, njofton KZAZ-në nëpërmjet ngritjes së dorës. Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të GNV-së, deri në marrjen e vendimit nga KZAZ-ja. KZAZ-ja numëron në vend votat për subjektin zgjedhor, objekt kundërshtimi dhe urdhëron Grupin e Numërimit të shënojë shifrën e vendosur prej saj në tabelën e rezultateve për atë qendër votimi, , Model 56-15 apo 57-15, sipas rastit, që harton GNV-ja.

## KREU VII - TRANSMETIMI ELEKTRONIK DHE NXJERRJA E TABELËS PËRMBLEDHËSE TË REZULTATIT TË ZGJEDHJEVE

### Kujdes!

Pas plotësimit të tabelës së rezultateve të çdo QV-je, KZAZ-ja të dërgojë elektronikisht në KQZ informacionin për rezultatin e zgjedhjeve të çdo QV-je për kandidatët dhe partitë politike.

### 1. Veprimet para plotësimit të Tabelës së Rezultateve të Votimit

Përpara plotësimit të Tabelës së Rezultateve të Votimit, për kryetar Bashkie nga anëtarët e GN-it, KZAZ-ja i jep sekretarit të GNV-së:

a. Bllokun me 5 fletë kimike (fleta e parë konsiderohet origjinale dhe 4 të tjerat kopje) të Tabelës së Rezultateve të Votimit Model 56-15, të QV-së përkatëse.

b. Vulat me kodet e sigurisë, të cilat shërbejnë për mbylljen e kutisë së votimit për kryetar. Numrat e këtyre kodeve të sigurisë shënohen Tabelën Origjinale të Rezultateve të Votimit Model 56-15 nga Sekretari i GN-it.

Sekretari i KZAZ-së shënon në Librin e Protokollit të Mbledhjeve të KZAZ-së

- ✓ numrin e GN-it dhe QV-së;
- ✓ numrat e kodeve të sigurisë.

c. Zarfat e Fletëve të Votimit për kryetar:

- Zarfi i fletëve të votimit të vlefshme për kandidatin për Kryetar Bashkie, Z.06a;
- Zarfi i fletëve të votimit të kontestuara për kandidatin për Kryetar Bashkie, Z.04a;
- Zarfi i fletëve të votimit të pavlefshme për kandidatin për Kryetar Bashkie, Z.05a;
- Zarfi i fletëve të votimit për kandidatin për Kryetar, të hedhura gabim në kutinë e Këshillit, ZO7/a;

ç. Para plotësimit të tabelës së rezultateve të QV-së përkatëse, Grupi i Numërimit të Votave kontrollon dhe sigurohet që:

- I. numri i zgjedhësve që kanë votuar duhet të jetë jo më i madh se numri i zgjedhësve që kanë votuar sipas shifrës së plotësuar në procesverbalin për mbylljen e votimit
  - a. (MODEL PV-KQV-08);
- II. numri i fletëve të votimit të gjetura në kuti duhet të jetë i barabartë me numrin e zgjedhësve që kanë votuar;
- III. numri i fletëve të votimit të gjetura në kuti të jetë i barabartë me shumën e votave të pavlefshme me votat e vlefshme dhe votat e hedhura gabim, kur ka të tilla;
- IV. numri i votave të vlefshme të jetë i barabartë me shumën e votave të vlefshme të shpërndara për subjektet zgjedhore të shënuara në fletën e votimit.

2. Transmetimi elektronik i të dhënave të pasqyruara në Tabelën e Rezultateve të QV-së, Model 56-15 dhe Model 57-15

Tabela origjinale e rezultateve për Qendrën e Votimit, sipas rastit për kryetar, Model 56-15, ose për këshillin, Model 57-15, i dorëzohet nga numëruesi i parë menjëherë KZAZ-së.

KZAZ përcjell në rrugë elektronike në KQZ, për çdo QV, informacionin që përmban tabela, Model 56-15 ose Model 57-15:

- numrin e zgjedhësve që kanë votuar;
- numrin e fletëve të votimit të papërdorura;
- numrin e fletëve të votimit të dëmtuara;
- numrin e fletëve të votimit të gjetura në kutinë e votimit;
- numrin e votave të pavlefshme;
- numrin e votave të vlefshme;
- numrin e fletëve të votimit të hedhura gabim;
- shpërndarjen e votave të vlefshme sipas rastit, për
  - ✓ kandidatët për kryetar bashkie (edhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit) ose
  - ✓ partitë politike dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit.

Kujdes! Në rast se çenohen kushtet e përmendura në pikat "ç.I" dhe "ç.II" të mësipërme ( 1 "a" dhe 1 "b" të nenit 4 të Udhëzimit të KOZ-së nr.1/2015) dhe pas verifikimeve që bën sekretari i KZAZ-së rezultojnë se:

Ë mospërputhja vjen nga ndonjë gabim njerëzor i bërë në VNV, lejohet korigjimi në sistem i shifrave;

Ë mospërputhja nuk vjen si pasoje e gabimeve njerezore, por pasqyron të dhënat që janë në Procesverbalin e Mbylljes së Votimit, aplikimi kompjuterik lejon vazhdimin e procesit duke bërë në sistem shënimin "mospërputhje".

Aplikimi kompjuterik nuk dotë lejohet për asnjë arsye çenimet e rregullave të përmendura në pikat "ç.III" dhe "ç.IV" (1 "c" dhe 1 "d" në nenin 4 të Udhëzimit të KOZ-së nr.1/2015).

Hedhja në sistemin elektronik të të dhënave dhe transmetimi i tyre realizohet menjëherë pas marrjes së tabelës së rezultateve nga GNV-ja. Ky proces vazhdon deri në përfundimin e vlerësimit të numërimit të votave dhe dorëzimit të të gjitha tabelave të rezultateve prej GNV-ve sipas kësaj mënyre:

a. Sekretari i KZAZ-së, pasi GNV-ja i dorëzon tabelën e rezultateve të një QV-je, ia jep atë operatorit teknik të hedhjes (të transmetimit) së të dhënave. Operatori i hedh të dhënat e tabelës së rezultateve në aplikimin elektronik në kompjuter dhe printon në letër informacionin që ka në formë elektronike. Në momentin e printimit aplikimi elektronik automatikisht bëhet i pa editueshëm/ipa shkrueshëm.

b. Tabela e printuar nga forma elektronike i dorëzohet GNV-së nga sekretari i KZAZ-së, për të verifikuar vërtetësinë e të dhënave.

b.1. Në rast se informacioni në tabelën e rezultateve të plotësuar me shkrim dore dhe ai i printuar nga sistemi elektronik janë të njëjta, sekretari i KZAZ-së i jep të drejtë operatorit dhe e udhëzon atë të dërgojë në rrugë elektronike rezultatet drejt KOZ-së.

b.2. Në rast se informacioni në tabelën e rezultateve të plotësuar me shkrim dore dhe ai i printuar nga sistemi elektronik janë të ndryshme, numëruesi i parë i GNV-së bën korigjimet me shkrim dore në fletën e printuar dhe kjo fletë firmoset nga anëtarët e GNV-së. Sekretari i KZAZ kthen aplikimin elektronik në të editueshëm/të shkrueshëm dhe udhëzon operatorin të bëjë korigjimin e të dhënave të pasakta dhe përsëritet procedura e printimit, verifikimit dhe dërgimit në KOZ.

Pas transmetimit të të dhënave të rezultateve të QV-së në KOZ, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të skanojë tabelën e rezultateve të plotësuar e firmosur nga GNV-ja dhe ta transmetojë atë në KOZ.

Formati i printuar dhe tabela origjinale e rezultateve i bashkëngjiten njëra-tjetrës dhe shërbejnë si dokumentacion zyrtar, që i dorëzohet KOZ-së.

Pas transmetimit të të dhënave të çdo QV-je në KOZ (sipas rastit tabela model 56-15 ose tabela model 57-15), kopje të tabelave të rezultateve (fotokopjohen në makinën printer/fotokopje/skaner, që ndodhet në VNV), të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, u jepen vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë.

### 3. Nxjerrja e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zgjedhjeve nga KZAZ-ja

#### 3.1. Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KZAZ-ja për Kryetarin e Bashkisë

Në përfundim të numërimit të të gjitha kutive të votimit për kryetarin e bashkisë, sekretari i KZAZ-së i kërkon operatorit të printojë nga baza elektronike e të dhënave Tabelën Përmbledhëse Provizore të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së për kryetarin e bashkisë në të cilën pasqyrohen rezultatet e çdo kandidati për çdo qendër votimi.

Tabela Përmbledhëse Provizore të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së për kryetarin e bashkisë, nuk përmban rezultatin e kutisë me vota për kryetarin, por të hedhura gabim në kutinë e këshillit të bashkisë.

Rezultati i pasqyruar në Tabelën Përmbledhëse Provizore të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së për kryetarin nuk është përfundimtar. Kjo tabelë dhe çdo publikim i saj përmban shënimin se rezultati nuk është përfundimtar.

Në përfundim të procedurës së përcaktuar në nenin 23 të Udhëzimit nr.5/2015, sekretari i KZAZ-së kërkon nga operatori të printojë nga baza elektronike e të dhënave e krijuar nga hedhja në të e rezultateve të të gjitha QV-ve, përfshirë dhe atë të kutisë së votave të hedhura gabim, Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së për kryetar të bashkisë.

Tabela Përmbledhëse e Rezultateve të ZAZ-së, e printuar, kontrollohet nga anëtarët dhe miratohet me vendim nga KZAZ-ja.

Pas miratimit, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të skanojë dhe dërgojë në rrugë elektronike në KOZ Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së për kryetarin e bashkisë të firmosur nga anëtarët e KZAZ-së.

Në rast se për arsye të ndryshme nuk mund të printohet Tabela Përmbledhëse e Rezultateve nga baza elektronike e të dhënave, atëherë sekretari i KZAZ-së plotëson me dorë Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të bashkisë, sipas rastit, për kryetarin modelin 39-15 ose për këshillin modelin 40-15.

Këto tabela përmbledhëse janë të paraprintuara me subjektet sipas përmbajtjes së fletës së votimit të bashkisë përkatëse. Në këto tabela pasqyrohen rezultatet e çdo subjekti, për çdo qendër votimi, sipas origjinaleve të tabelave të rezultateve të QV-ve, të bashkisë përkatëse plotësuar nga GN-të.

Tabela Përmbledhëse e Rezultateve për bashkitë që mbulohen nga një ZAZ kanë edhe shumën e votave që merr çdo subjekt në rang bashkie.

ato (bashki) që mbulohen nga më shumë se një ZAZ nuk duhet të kenë shumën e votave.

Kopje të Tabelës Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve të çdo bashkie, kopje të tabelave të rezultateve të qendrave të votimit dhe kopje të Procesverbalit të Konstatimit, u jepen anëtarëve të KZAZ-së dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, ndërsa origjinalet e tyre, vulat dhe çdo material tjetër zgjedhor dorëzohen në KOZ.

Kujdes : Procedurat për transmetimin elektronik të të dhënave të pasqyruara në Tabelën e Rezultateve të QV-së dhe nxjerrja e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatit të Zgjedhjeve për bashkinë, janë të njëjta si për rezultatin "Për kryetarin e bashkisë" dhe për rezultatin "Për këshillin bashkiak".

Tabela përmbledhëse e rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor nxirret nga KZAZ-ja jo më vonë se ora 22<sup>00</sup> e ditës së nesërme të votimit, KZ, neni 122/1.

### 3.2.Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KZAZ-ja për këshillin bashkiak

Në përfundim të numërimit të të gjitha kutive të votimit për këshillin e bashkisë, përfshirë dhe kutinë e posaçme me votat e hedhura gabim, sekretari i KZAZ-së i kërkon operatorit të printojë nga baza elektronike e të dhënave e krijuar nga hedhja në të e rezultateve të të gjitha QV-ve, përfshirë dhe atë të kutisë së votave të hedhura gabim, Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së për këshillin e bashkisë.

Tabela Përmbledhëse e Rezultateve të Zgjedhjeve të ZAZ-së për këshillin e bashkisë, e printuar, kontrollohet nga anëtarët dhe miratohet me vendim nga KZAZ-ja. Pas miratimit, sekretari i KZAZ-së udhëzon operatorin të skanojë dhe dërgojë në rrugë elektronike në KOZ

Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve të ZAZ-së për këshillin e bashkisë të firmosur nga anëtarët e KZAZ-së.

Në rast se KZAZ-ja nuk arrin të marrë vendim për miratimin e Tabelës Përmbledhëse të Rezultatevetë Zgjedhjeve të ZAZ-së për këshillin e bashkisë, kryetari ose të paktën dy anëtarë të KZAZ-së dërgojnë çështjen për shqyrtim në KOZ.

Kopje të Tabelës Përmbledhëse të Rezultatevetë Zgjedhjeve të ZAZ-së për këshillin e bashkisë, të vulosura nga sekretari i KZAZ-së me vulën e KZAZ-së, u jepen anëtarëve të KZAZ-së, vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nëse i kërkojnë.

#### 4. Ankesa

Vendimi i KZAZ-së për miratimin e tabelës përmbledhëse të Rezultatit të Zgjedhjeve të ZAZ-së, çdo vendim i marrë gjatë procedurës së marrjes në dorëzim të materialeve dhe dokumentacionit zgjedhor nga KOV-të, si dhe gjatë numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit të votimit, janë vendime të ndërmjetme dhe ankimohen në KOZ. Ankimi ka formën e kërkesës ankimore, MODEL – 02 K.A.P, të miratuar nga KOZ me Vendimin nr.10, datë 21.01.2015, të cilën e keni të pasqyruar edhe në Fletoren e Punës së KZAZ, pjesa e parë.

#### KREU VIII - PAS ZGJEDHJEVE - DËRGIMI I MATERIALEVE ZGJEDHORE NË KOZ

Menjëherë pas përfundimit të procedurave të nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve, Kryetari, Zv.Kryetari dhe Sekretari i KZAZ-së dorëzonnë KOZ,

- në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Logjistikës Zgjedhore me procesverbal:

MODELI	Përmbajtja e Procesverbalit
MODELPV–KZAZ-13	- Kutitë e votimit me fletët e votimit; - Kutitë e materialeve zgjedhore
PV-KZAZ –11	- Materialet zgjedhore të inventarizuara me: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Telefaks;</li> <li>• Makinë llogaritëse;</li> <li>• Pinca metalike;</li> <li>• Këmbë druri me bazament kryqi</li> <li>• Aparat fotokopje</li> </ul> Elemente ndarëse për tavolinat e numërimit

- në ZRAD, dokumentet origjinale, veçmas me procesverbal:

MODEL PV-KZAZ-12	
Model 39-15	Tabelë përmbledhëse e rezultateve për bashkinë, për kryetarin;
Model 39-15-P	Tabelë përmbledhëse provizore e rezultateve për bashkinë, për kryetarin;
Model 40-15	Tabelë përmbledhëse e rezultateve për bashkinë, për këshillin;
Model 39-15-V	Vendim i KZAZ-së për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për bashkinë, për zgjedhjen e kryetarit;
Model 40-15-V	Vendim i KZAZ-së për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultateve për bashkinë, për zgjedhjen e këshillit.
Model 56-15	Tabelë e rezultateve për QV-në, për kryetarin e bashkisë;
Model 56-15-G	Tabelë e rezultateve për kryetarin për fletët e votimit të hedhura



	gabim;
Model 57-15	Tabelë e rezultateve për QV-në, për këshillin e bashkisë;
Model 57-15-G	Tabelë e rezultateve për këshillin për fletët e votimit të hedhura gabim;
- Librin e Protokollit të Mbledhjeve (LPM);	
- Procesverbalin e Konstatimit;	
- Vulën e KZAZ-së;	
- Regjistrin e Vendimeve KZAZ-së;	
- Regjistrin e Korrespondencës;	
- Vendimet për emërimin/lirimin/shkarkimin anëtarëve të KQV-ve;	
- Vendimet për emërimin/shkarkimin anëtarëve të GNV-ve;	
Model PV-KZAZ-12-1	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Listën e emrave dhe adresave të të gjithë anëtarëve të KZAZ-së, KQV-ve, GNV-ve;</li> <li>- Listën e qendrave të votimit;</li> <li>- Listën e zgjedhësve për Zonën Zgjedhore;</li> <li>- Hartën e Zonës Zgjedhore me kufijtë e zonave të qendrave të votimit;</li> <li>- Përshkrimin me shkrim të kufijve të të gjitha zonave të administrimit zgjedhor;</li> <li>- Deklaratë të shpenzimeve të bëra për administrimin e zgjedhjeve.</li> </ul>

KZAZ-ja është përgjegjëse për ruajtjen e dokumentacionit të zgjedhjeve, materialeve zgjedhore.

**Kujdes:**

Së bashku me materialet e tjera zgjedhore dorëzoni në KQZ: Regjistrimin filmik të procesit të regjistrimit për shfaqjen e fletëve të votimit përpara vlerësimit të tyre dhe vlerësimit të çdo flete votimi, i cili ruhet në mënyrë elektronike.

Asnjë procesverbal i KQV-së, GNV-së dhe KZAZ-së nuk mund të asgjësohet pa miratimin paraprak të KQZ-së.

**Kujdes:**

Ju mund t'i referoheni n.178 të KZ, pikave 1, 3, 4 dhe Vendimeve të KQZ-së nr.18/2015 vendimit 144/2015.

Kryetari i KZAZ-së së bashku me zv.kryetarin dhe sekretarin e KZAZ-së dorëzon në KQZ, pas shpalljes së rezultatit, dokumentacionin dhe materialin zgjedhor.

Në rast se nuk do të dorëzohen të gjitha materialet e inventarizuara, vlera financiare e tyre do të mbahet nga pagesa e anëtarëve të KZAZ-së. Nëse do të ketë raste të dëmtimit, thyerjes, apo humbjes së materialeve jo për faj të dorëzuesit, ju nuk do të mbani përgjegjësi financiare, vetëm nëse do të vërtetoni dëmin ekonomik me anë të një proces-verbali të vulosur dhe firmosur nga Kryetari, N/Kryetari dhe Sekretari i KZAZ-së.

Për efekt verifikimi, procesverbali, Model PV-KZAZ-11, mbahet në 3 (tre) kopje. Kopja origjinale (faqja e parë) e këtij proces-verbali do të dorëzohet në Zyrën e Financës, pranë KQZ-së, e cila do të bëjë edhe verifikimin e vlerës së materialeve të dorëzuara në KQZ pas përfundimit të procesit zgjedhor.

## KREU IX - PËGJEGJËSITË DHE SANKSIONET E ANËTARËVE TË KZAZ-SË dhe GNV-së

Anëtarët ekomisioneve zgjedhore dhe nëpunësit e administratës publike në shërbim të këtyre komisioneve mbajnë përgjegjësi penale dhe administrative, sipas legjislacionit:

Veprat penale:

- Falsifikimi i dokumenteve dhe rezultateve të zgjedhjeve (n. 326 )
- Dëmtimi me dashje i materialit zgjedhor (n. 326/a)
- Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje(n. 329)
- Braktisja e detyrës nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve (n. 330/a)
- Shkeljet e përcaktuara në pikat 1,2, 5 të nenit 171, janë rastet e përgjegjësive penale dhe administrative të anëtarëve të GN-it.

Kujdes!

Numëruesi i parë dhe sekretari i GN-it janë përgjegjës për zbatimin e detyrimeve që lindin nga kontestimi i fletëve të votimit. Mospërbushja e këtyre detyrimeve, sipas n.171 të KZ, ndëshkohet me gjobë, KZ, neni118/7.

Kur me veprimet e tij anëtari i GN shkel ndonjë nga parimet e përgjithshme të përcaktuara në nenin 3 të Kodit Zgjedhor, ndaj tij vendoset sanksione (KZ, neni 172):

- kur shkelja nuk ka ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 500 000 lekë (n.172, p.1);
- Kur shkelja ka ndikuar në rezultatin e zgjedhjeve, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 2 vjet ( n.172/4).

Kujdes! Refuzimi për të numëruar sjell shkarkimin e menjëhershëm të personave të ngarkuar për numërimin ose, sipas rastit, KZAZ-së.

Refuzimi për të numëruar kutinë e pranuar si të rregullt përbën veprë penale dhe ndëshkohet sipas nenit 330/a të Kodit Penal. Udhëzimi i KQZ-së nr.5/2015, neni 11.

## KREU X- SHEMBUJ PRAKTIKË TË VEPRIMEVE TË KZAZ-SË

i.Çfarë duhet të bëjë KZAZ, nëse dëmtohet vula e KZAZ-së?

Njofton me shkresë përcjellëse dhe /tel/fax/email, menjëherë, KQZ-në dhe Inspektorin e Zyrës Rajonale Zgjedhore (ZRZ).

Shkresa duhet të përmbajë këto elementë:

- Numrin e KZAZ-së;
- Qarkun;
- Datën dhe orën e dërgimit;
- Kujt i drejtohet KZAZ ?- KQZ dhe Inspektorit të ZRZ-së;
- Rrethanat e dëmtimit të vulës;
- Ora dhe data e dëmtimit të saj;
- Kërkon zëvendësimin e vulës së KZAZ-së me vulë të re;
- Shkresa duhet të jetë e vulosur (për të parë edhe sa është dëmtuar vula) dhe firmosur nga anëtarët e KZAZ-së dhe Sekretari i KZAZ-së, i cili shënon: "Vula e dëmtuar", përbri firmës së tij.



Kujdes: KZAZ vazhdon punën, shënon faktin konkret në Librin e Protokollit të Mbledhjeve

Për sa më sipër, Sekretari i KZAZ mban procesverbalin në LPM dhe kopje e tij i bashkëlidhet shkresës, e cila regjistrohet në Regjistrin e Korrespondencës. Kopja origjinale e shkresës mbahet në arkivin e KZAZ-së nga Sekretari i saj. Inspektori i ZRZ-së dërgon në KZAZ vulën rezervë, pasi të jetë marrë vendimi nga KQZ "Për pajisjen e KZAZ nr... me vulën rezervë".

ii.Çfarë duhet të bëjë KZAZ, nëse, gjatë votimit, vula e KQV-së dëmtohet ose humbet/ ose nxirret jashtë qendrës së votimit?



Menjëherë njofton me shkresë përcjellëse dhe tel/fax/email, KQZ-në dhe Inspektorin ZRZ, si dhe Komisarariatit përkatës të Policisë së Shtetit humbjen e vulës së KQV-së.

Shkresa duhet të ketë këto elementë:

- Numrin e KZAZ-së;
- Qarkun;
- Kujt i drejtohet KZAZ?- KQZ-së, Inspektorit të ZRZ-së dhe Komisarariatit të Policisë së Shtetit;
- Rrethanat e humbjes së vulës;
- Numrin e KQV-së;
- Kopje të procesverbalit të KQV-së;
- Kopje të vendimit të KQV-së "Për pezullimin e votimit"
- Kërkon zëvendësimin e vulës së dëmtuar gjatë votimit, ose humbur/ ose nxjerrë jashtë qendrës së votimit të KQV-së, nr.... , me vulë të re.
- Shkresa duhet të jetë e firmosur nga anëtarët e KZAZ-së dhe e vulosur nga Sekretari i KZAZ-së.

Kujdes: KQV pezullon votimin dhe menjëherë merr vendim "Për pezullimin e votimit". KQV njofton menjëherë, me telefon (me të gjitha mënyrat e njoftimit) KZAZ-në. Menjëherë KZAZ njofton Inspektorin e ZRZ-së dhe KQZ-në. Pasi të jetë marrë vendimi nga KQZ "Për zëvendësimin e vulës së KQV-së nr.... dhe "pajisjen e saj me vulën rezervë", Inspektori i ZRZ-së, në pamundësi të tij, një anëtar i KZAZ-së dërgon në KQV vulën rezervë.

iii. Çfarë duhet të bëjë KZAZ, nëse përfaqësuesi i një subjekti zgjedhor paraqet ankesë "Anëtari A.Z. i KQV-së nr....nuk plotëson një nga kushtet e nenit 38, sepse nuk është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse"?

Ankuesi ka depozituar së bashku me ankesën edhe prova, dokumente që vërtetojnë se anëtari KQV-së nuk plotëson një nga kushtet e nenit 38/ 1/"c".

KZAZ:

- duhet të shqyrtojë provat. Në këtë rast, prova, dokumenti është certifikata personale, e 30 ditëve të fundit, e cila provon se vendbanim i anëtarit të KQV-së nuk është brenda zonës zgjedhore përkatëse, përbën shkak për lirin e tij nga detyra.
- merr vendim për lirin e anëtarit të KQV-së;
- njofton subjektin zgjedhor (degën lokale të partisë politike përkatëse) për zëvendësimin e anëtarit të KQV-së me një person tjetër.

Kujdes: KZAZ vazhdon procedurën e vendimmarrjes:

- Subjekti zgjedhor, duhet të paraqesë në KZAZ-në përkatëse, së bashku me propozimin edhe dokumentacionin e nevojshëm për anëtarin e ri të KQV-së:
  - Certifikatë personale ose fotokopje e letër njoftimit;
  - Deftesë e shkollës së mesme, në rastin e propozimit të anëtarit të KQV-së;
  - Diplomë e shkollës së lartë, \*Në rastin e propozimit të Sekretarit të KQV-së;
  - Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
  - Deklaratë personale e tij, që nuk ka marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme.

- iv. Çfarë duhet të bëjë KZAZ, nëse përfaqësuesi i një subjekti zgjedhor paraqet ankesë "Anëtari Y.Z. i GN-it nuk plotëson një nga kushtet e nenit 38, sepse nuk është me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse"?

Ankuesi nuk ka depozituar prova, dokumente që vërtetojnë se anëtari i GN-it nuk plotëson një nga kushtet e nenit 38/ 1/"c".

KZAZ:

- i kthen përgjigje me shkrim ankuesit dhe
- i kërkon atij, për të vërtetuar pretendimin, të depozitojë certifikatën personale, të 30 ditëve të fundit, pranë KZAZ-së.

Nëse pas depozitimit të saj rezulton se vendbanimi i anëtarit të GN-it nuk është brenda zonës zgjedhore përkatëse, përbën shkak për lirim të tij nga detyra.

Kujdes: KZAZ vazhdon procedurën si në shembullin "iii", dhe pasi verifikon dokumentacionin e paraqitur nga Subjekti zgjedhor së bashku me propozimin për anëtarin e ri të GN-it, merr vendim bazuar në dokumentacionin e nevojshëm:

- Certifikatë personale ose fotokopje e letër njoftimit;
- Fotokopje e letërnjoftimit;
- Kopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore.
- Deklaratë personale e tij, që nuk ka marrë masë disiplinore në proceset zgjedhore të mëparshme.

- v. Çfarë duhet të bëjë KZAZ, nëse përfaqësuesi i një subjekti zgjedhor paraqet ankesë "Anëtari A.ZH. i KQV-së nr..... bllokoi procesin e votimi, me qëllim zvarritjen e tij, për të kaluar në pavlefshmëri të zgjedhjeve" ?

A. KZAZ menjëherë:

- merr në shqyrtim ankesën;
- verifikon nëse është bllokuar procesi i votimit, me të gjitha mjetet (telefon dhe/ose dërgon në KQV dy anëtarë të KZAZ-së të spektërve të kundërt politik);

dhe nëse procesi është bllokuar me qëllim zvarritjen e tij, informon urgjentisht KQZ-në, DKZTEZ-në dhe Inspektorin Rajonal, bazuar në informacionin me shkrim të KQV-së dhe/ose dy anëtarë të KZAZ-së të spektërve të kundërt politik me të gjitha mënyrat e komunikimit (telefon/fax).

Paraprakisht KZAZ verifikon emrat e anëtarëve të KQV-së nr..... dhe ia dërgon KQZ-së, së bashku me informacionin/et.

Më pas, KZAZ:

- i shkarkon anëtarët e KQV-së nr.....;
- i zëvendëson ata me anëtarët të tjerë sipas propozimeve të bëra nga subjektet zgjedhore përkatëse;

Kur KQV-ja mbetet pa kuorum, për shkak të mungesave të anëtarëve dhe me kalimin e afatit, 2 orë, nuk është kryer zëvendësimi, KZAZ-ja urdhëron vazhdimin e procedurave dhe merr masa për plotësimin kryesisht të vakancës.

Zëvendësimi i anëtarëve dhe sekretarit të KQV-së bëhet, si rregull, me persona, të cilët kanë trajnim për legjislacionin zgjedhor.

Kujdes: Informacioni drejtuar KZAZ dhe/ose KQZ-së duhet të ketë elementet e përshkruar në shembullin "ii". KZAZ lidhur me procedurën e mbledhjes dhe vendimmarrjes vepron si në shembullin "iii".

- B. Nëse KZAZ nuk merr në shqyrtim ankesën ose nuk arrin të zgjidhë situatën e bllokimit të procesit, çdo anëtar i KZAZ-së mund të informojë KQZ-në për zhbllokimin e situatës.

vi. Çfarë duhet të bëjë KZAZ, nëse përfaqësuesi i një subjekti zgjedhor paraqet ankesë "anëtarët e GN-it nr.5, KZAZ-së nr.9, qarku Shkodër kanë bllokuar procesin e numërimit me qëllim zvarritjen e procesit" ?

A. KZAZ menjëherë:

- merr në shqyrtim ankesën;
  - verifikon nëse është bllokuar procesi i numërimit;
- dhe nëse procesi është bllokuar me qëllim zvarritjen e procesit, informon urgjentisht KOZ-në, DKZTEZ-në dhe Inspektorin Rajonal me të gjitha mënyrat e komunikimit (telefon/fax/email).

Paraprakisht KZAZ verifikon emrat e anëtarëve të Grupit të Numërimit nr.5 dhe ia ia dërgon KOZ-së, së bashku me informacionin.

Më pas, KZAZ:

- i shkarkon anëtarët e GN-it nr.5;
- i zëvendëson ata me anëtarët të tjerë sipas propozimeve të bëra nga subjektet zgjedhore përkatëse;

Kujdes: Informacioni drejtuar KOZ-së duhet të ketë elementet e përshkruar në shembullin "ii". KZAZ lidhur me procedurën e mbledhjes dhe vendimmarrjes vepron si në shembullin "iii".

B.Nëse KZAZ nuk merr në shqyrtim ankesën ose nuk arrin të zgjidhë situatën e bllokimit të procesit, çdo anëtar i KZAZ-së mund të informojë KOZ-në për zhblokimin e situatës.

Kujdes! Në çdo rast, ankesa duhet të ketë elementët e përshkruar në kreun "Ankesa", në Kodin Zgjedhor, neni 124 dhe Manualin e KZAZ-së, pjesa e parë. Vendimet e KZAZ-së ankimohen në KOZ. Dy anëtarë të KZAZ-së kanë të drejtë të bëjnë ankim në KOZ.

vii. Ku shpallet rezultati i zgjedhjeve për kryetar bashkie të mbështetur nga partia politike/koalicioni, po për kryetar bashkie të mbështetur nga zgjedhësit?

- KZAZ, miraton Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për kryetar bashkie, Model 39-15 dhe merr vendimin "Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjen e kryetarit të bashkisë", Model 39-15V.
- Tabela Model 39-15 dhe vendimi Model 39-15V dërgohen në KOZ.

KZAZ shpall vendimin për kryetarin e bashkisë, për atë ZAZ, kur territori i bashkisë, mbulohet nga një KZAZ e vetme.

- Një kopje të vendimit e mban KZAZ,
  - një kopje i jepet Kryetarit të bashkisë dhe
  - një kopje e dërgon në KOZ.
- ❖ Rezultati i zgjedhjeve për kryetar bashkie të mbështetur nga partia politike/koalicioni, dhe për kryetar bashkie të mbështetur nga zgjedhësit shpallet nga KZAZ, me vendim.

Kujdes!

Në rastet kur territori i bashkisë nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme, çdo KZAZ miraton me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve, vetëm për atë pjesë të territorit të bashkisë, që ajo mbulon dhe rezultati i zgjedhjeve për kryetar bashkie në këtë zonë zgjedhore shpallet nga KOZ.

Tabela Përmbledhëse e Rezultateve firmoset nga anëtarët e KZAZ-së.

Sekretari i KZAZ-së plotëson me dorë Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve, në rast se për arsye të ndryshme, ajo nuk mund të printohet nga baza elektronike e të dhënave.

Vendimi Model 39-15V ka formë ligjore, kur:

a. është i firmosur nga të gjithë anëtarët e KZAZ-së dhe në kolonën përkatëse (përbri firmës) ka shënimin "Pro" ose "Kundër", si dhe i vulosur nga Sekretari i KZAZ-së.

b. ka të paktën 4 (katër) vota "Pro" dhe i vulosur nga Sekretari i KZAZ-së.

Anëtari i KZAZ-së, që firmos "Kundër", duhet të japë mendimin e tij të pakicës, në pjesën e pasme të vendimit.

viii. Ku shpallet rezultati i zgjedhjeve për këshillin e bashkisë, po për anëtarin e këshillit bashkiak të mbështetur nga zgjedhësit?

- KZAZ, miraton Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve për këshillin e bashkisë, Model 40-15 dhe merr vendimin "Për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit për zgjedhjen e këshillit bashkiak", Model 40-15V".

Kujdes! Në rastet kur territori i bashkisë nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme, çdo KZAZ miraton me vendim Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve, vetëm për atë pjesë të territorit të bashkisë, që ajo mbulondhe rezultati i zgjedhjeve për këshill bashkie në këtë zonë zgjedhore shpallet nga KOZ.

- Tabela Model 40-15 dhe vendimi Model 40-15V dërgohen në KOZ.
- Kopje e tyre u jepen anëtarëve të KZAZ-së, vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, ndërsa origjinali dërgohet në KOZ.
- KOZ ndan mandatet për këshillin e bashkisë dhe përcakton nga lista shumemërore se kujt kandidati i përket mandati për çdo bashki dhe çdo subjekt.

Kujdes! Tabela Përmbledhëse e Rezultateve firmoset nga anëtarët e KZAZ-së.

Sekretari i KZAZ-së plotëson me dorë Tabelën Përmbledhëse të Rezultateve, në rast se për arsye të ndryshme, ajo nuk mund të printohet nga baza elektronike e të dhënave.

Vendimi Model 39-15V ka formë ligjore, kur:

a. është i firmosur nga të gjithë anëtarët e KZAZ-së dhe në kolonën përkatëse (përbri firmës) ka shënimin "Pro" ose "Kundër", si dhe i vulosur nga Sekretari i KZAZ-së.

b. ka të paktën 4 (katër) vota "Pro" dhe i vulosur nga Sekretari i KZAZ-së.

Anëtari i KZAZ-së, që firmos "Kundër", duhet të japë mendimin e tij të pakicës, në pjesën e pasme të vendimit.





**KOMISIONI  
QENDROR  
I ZGJEDHJEVE**

**PER ORGANET  
E QEVERISJES VENDORE**  
**VOTONI!**

**Pallati i Kongreseve, Blvd. "Dëshmorët e Kombit" Tiranë,  
E-Mail: [infosec@cec.org.al](mailto:infosec@cec.org.al) [commissions@cec.org.al](mailto:commissions@cec.org.al)  
Tel: 044104650/ 662 /683 [www.cec.org.al](http://www.cec.org.al)**